



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>2-D/DPK</b>	Nr. Prot. Br. Prot. <b>01-3364/13</b>
Nr. i faq. Broj stranica <b>02</b>	Data Datum <b>14.10.2013</b>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 (paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.10.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2706/13, për z. Skender Hyseni – Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia”, për shkak se zyrtari i lartë tashmë nuk e ushtron këtë funksion publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2706/13, për zyrtarin e lartë z. Skender Hyseni – Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia”, dhe njëkohësisht person i autorizuar në D.P. “GLASS COM”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Hyseni është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe me datë 16.09.2013 është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, përmes telefonit ka kontaktuar Agjencinë dhe ka deklaruar se më nuk ushtron funksionin e tij si Anëtar i Bordit të Drejtorëve në Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia”.

Pas kësaj, z. Hyseni, me kërkesën e Agjencisë ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga KRM "Pastërtia" (DPKI 03-3061/13) në të cilën vërtetohet se të njëjtit i ka skaduar mandati me datën 11.09.2013.

Andaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e konfliktit të interesit është shmangur pasi që z. Skender Hyseni tashmë nuk ushtron funksionin e lartpërmendur publik dhe rrjedhimisht nuk është zyrtar i lartë publik.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

